



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

---

**V E N D I M  
Nr. 53, date 24.06.2019**

**PËR DHËNIEN E TITULLIT VENDOR TË NDERIT  
“MIRËNJOHJA E BASHKISË SHKODËR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 19.06.2018, me propozim të këshilltarit z. Filip Guraziu, mbështetur në nenin 54 shkronja “m”, neni 55 pika 2, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 15 të ligjit nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënie e medaljeve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr. 61, datë 30.11.2016 “Rregullore për titujt vendorë të nderit në Bashkinë Shkodër, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre“, relacionit datë 11.06.2018 të komisionit këshillimor për titujt vendorë të nderit në Bashkinë Shkodër,

**V E N D O S I:**

1. Dhënie e titullit vendor të nderit “Mirënjohja e Bashkisë Shkodër” për familjen **Benussi** (*Gjiorgjio, Gaspër, Gjush, Baltasar, Zef e Luigj*), me motivacionin:

*“Për kontribut të shquar patriotik, kulturor dhe shkencor në shërbim të përparimit të shoqërisë shkodrane dhe shqiptare të dhënë ndër shekuj, nga familja dhe pjestarët e familjes me origjinë italiane Benussi: (Gjiorgjio, Gaspër, Gjush, Baltasar, Zef e Luigj)”.*

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sekretari i këshillit bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 24.6.2019  
Shpallur në datën 24.6.2019

**Sekretar i këshillit**

**K R Y E T A R**

---

**Suel Hadri**

---

**Xhemal BUSHATI**